

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Kolegji për të mitur i përbërë nga gjyqtarët Abdullah Ahmeti, kryetar i kolegjit, gjyqtarët Hashim Çollaku dhe Ferit Osmani, anëtarë, me bashkëpunatoren profesionale Leonita Lajçi, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit të akuzuarit B.S., nga Ferizaj, për shkak të veprës penale keqpërdorimi seksual i personave nën moshën 16 vjet, nga neni 235 par.2 nënpar.2.3 lidhur me par.1 të KPRK, duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësit të akuzuarit B.S., av. B.H., të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, PKR.nr.39/2018, të dt.18.04.2018, me datën 15.10.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me aprovimin e ankesës së mbrojtësit të akuzuarit B.S., av. B.H., **ndryshohet** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, PKR.nr.39/2018, të dt.18.04.2018, përkitazi me vendimin për dënimin me burgim, ashtu që kolegji i kësaj gjykate të akuzuarit B.S., për shkak të veprës penale keqpërdorimi seksual i personave nën moshën 16 vjet, nga neni 235 par.2 nënpar.2.3 lidhur me par.1 të KPRK, i shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 5 (pesë) viteve.

Në dënimin e shqiptuar me burgim, i llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga dt.26.01.2018, derisa i akuzuari ta përfundon dënimin e shqiptuar sipas këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore në Ferizaj, PKR.nr.39/2018, të dt.18.04.2018, është shpallur fajtor i akuzuari B.S., nga Ferizaj, për shkak të veprës penale keqpërdorimi seksual i personave nën moshën 16 vjet, nga neni 235 par.2 nënpar.2.3 lidhur me par.1 të KPRK, dhe i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) viti, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 26.01.2018, derisa aktgjykimi të merr formën e prerë, por jo më gjatë se dënimi i shqiptuar më aktgjykim.

Është obliguar i akuzuari që të paguajë shpenzimet e procedurës penale sado që të jenë ato sipas llogarisë së bërë në arkë të gjykatës, paushallin gjyqësor në shumën prej 50 (pesëdhjetë) €, si dhe në emër të kompensimit të viktimave të dhunës, shumën prej 50 (pesëdhjetë) €, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Përfaqësuesi ligjor i të dëmtuarit L.Q. babai RH.Q., për realizimin e kërkesës pasurore juridik është udhëzuar në kontestin e rregullt juridiko-civil.

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor ka ushtruar ankesë, B.S., av. B.H., për shkak të vendimit për dënimin, duke propozuar që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit ti shqiptohet një dënim më i butë, më të cilin do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë me shkresën PPAM/I.nr.82/2018, të datës 12.09.2018, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e ushtruar, ka propozuar që e njëjta të refuzohet si e pabazuar, kurse aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Në kuptim të nenit 390 të KPPK, kolegji ka caktuar seancën e kolegjit, për të cilën i ka njoftuar në mënyrë të rregullt të gjitha palët nga shkresat e lëndës. Nga shkresat e lëndës rezulton se njoftimeve iu janë përgjigjur i akuzuari B.S., i cili është sjelle nga Qendra e Paraburgimit. Në seancën e kolegjit nuk kanë prezantuar mbrojtësi B.H., i dëmtuari L.Q. dhe përfaqësuesi i tij ligjor prindi RH.Q., përfaqësuesi i Prokurorisë së Apelit edhe pse janë njoftuar me rregulle.

Me pëlqimin e të akuzuarit për seancën e kolegjit, është angazhuar mbrojtësi av. H.K., i caktuar sipas detyrës zyrtare.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenit 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesa e ushtruar, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, si dhe shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

Ankesa e mbrojtësit të akuzuarit B.S., av. B.H., nuk është e bazuar.

Meqenëse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, gjykata duke vepruar në pajtim me nenin 394 të KPPK, e shqyrtoj aktgjykimin e ankimuar nëse i njëjti është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, dhe gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit, të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij, për të cilat kjo gjykatë kujdeset kryesisht sipas detyrës zyrtare.

Sipas ankesë së mbrojtësit të akuzuarit, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar për shkak të vendimit për dënimin, duke theksuar se vendimi për dënimin është i ashpër, pavarësisht që përshkrimi i dispozitës ligjore parasheh dënime të ashpër, mirëpo duke patur parasysh që i akuzuari ka prekur në organin gjenital të të miturit, i njëjti nuk ka patur qëllime seksuale, por të gjitha këto janë ndërmarre dhe kryer duke prekur dhe ledhatuar njëri-tjetrin pa përdorim të kanosjes apo forcës, jo më qëllim të kryerjes së aktit seksual, por me tepër është dashur që të kihet parasysh që i akuzuari është më të meta psikike, që ngjihet si ‘pedofil’, andaj gjykata e shkallës së parë është dashur që ti vlerëson rrethanat lehtësuese se i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale të cilat i vihet në barrë, se ka premtuar që në të ardhmen nuk do të përsëris vepra të tilla penale, se është penduar për kryerjen e veprës penale, se veprën penale e ka kryer rastësisht, së është i gjendjes së varfër ekonomike, është familjar dhe mbajtës i familjes 7

anëtareshe që të gjithë të moshës jo madhore, andaj propozojmë që të njëjtit ti zbutet vendim për dënimin, i cili do të jetë adekuat më përgjegjës në penalo-juridike të akuzuarit.

Kolegji për të mitur i kësaj gjykate ka vlerësuar ankesën e ushtruar, aktgjykimin e ankimuar si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim, se me aktgjykimin e ankimuar gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, se i njëjti nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkeljet të ligjit penal, se gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së vendimit për dënimin, caktimit të llojit dhe lartësisë së tij, në kuptim të nenit 73 të KPK, i ka vlerësuar të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në marrjen e vendimit për dënimin, sikurse janë rrethanat lehtësuese, se i akuzuari ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, se ka patur sjellje korrekte në gjykatë, se për herë të parë ka rënë në kundërshtim me ligjin, se është mbajtës i vetëm i familjes, ashtu që kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar këto rrethana lehtësuese e sidomos ka vlerësuar gjendjen ekonomike të akuzuarit si dhe faktin që i njëjti është familjar dhe mbajtës i familjes 7 anëtareshe të moshës jo madhore, që të gjitha këto çështje të aprostopuara në ankesën e mbrojtësit të akuzuarit. Andaj, në praninë të këtyre rrethanave kolegji i kësaj gjykate e ka ndryshuar vendimin për dënimin sikurse në dispozitiv të aktgjykimin, duke qenë i bindur se dënimi i shqiptuar është proporcional më përgjegjës në penalo-juridike të akuzuarit dhe se me një dënim të shqiptuar sikurse në dispozitiv të aktgjykimin do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij i paraparë me nenin 41 të KPK, që të parandalojë kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale, dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 403 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR. nr.419/2018, të datës 15.10.2018

B.profesionale
Leonita Lajçi

Anëtarët e kolegjit
Hashim Çollaku

Kryetar i kolegjit
Abdullah Ahmeti

Ferit Osmani